

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6968  
E hënë, 14 gusht 2023  
Çmimi 0.40

Kievi raporton për të paktën 500 fëmijë të vrarë që nga nisja e pushtimit. FAQE 2



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## PENDAROVSKI KËRKON SANKSIONE PËR 'PROVOKIMET NACIONALISTE' GJATË VIZITËS SË KURTIT FAQE 3



Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka kërkuar sanksionimin e drejtuesve të komunës së Çairit dhe Tetovës për, siç ka thënë, "provokimet nacionaliste që propozojnë ide shoviniste të shteteve të mëdha"

gjatë vizitës së kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, të premtën, më 11 gusht, në Tetovë dhe Çair të Shkupit. Kurti ishte pritur me ikonografi shqiptare, flamuj dhe simbole të tjera kombëtare shqiptare. "Vendosja e

ikonografisë provokuese nacionaliste, që promovon ide shoviniste të shteteve të mëdha, paraqet nxitje të urrejtjes dhe jotolerancës etnike...", u tha në reagimin e presidentit maqedonas

## PROTESTË NË 'MBROJTJE' TË KURTIT NGA OPOZITA DHE ANALISTËT FAQE 7



## RAMA: TË QENIT I MAJTË S'MË PENGON TË BËJ ZGJIDHJE QË MUND TË INTERPRETOHEN SI TË DJATHTA



### AKTUALE



DW: LETRA ANONIME KUNDËR XHAMIVE NË GJERMANI F. 2

GAZETARET UKRAINASE: NJOHJA E KOSOVËS, THJESHT ÇËSHTJE KOHE F. 6

URDHRI OPERATIV "GODITJA", PËR PESË DITË 72 TË ARRESTUAR DHE 34 ARMË TË KONFISKUARA F. 5

### EKONOMI



POLICIA E KOSOVËS NË DY RASTE TË NDARA PARANDALON KONTRABANDË TË MALLRAVE NGA SERBIA F. 7

MASAT E BE-SË, RAFUNA: PASOJA NË EKONOMI, PO DËMTOHET IMAZHI NË SYTË E INVESTITORËVE TË HUAJ F. 7

### SPORT



BALLKANI E DRITA E NISIN SEZONIN E RI ME FITORE F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Shkon në 89 numri i viktimave nga zjarret në Havai

LAHAINA, 13 GUSHT - Numri i viktimave nga zjarret në Maui të Havait ka arritur në 89, përdërisa autoritetet kanë paralajmëruar se përpjekjet për të gjetur dhe identifikuar viktimat janë ende në fazat fillestare.

Zjarret në Maui janë fatkeqësia më vdekjeprurëse natyrore në Shtetet e Bashkuara për më shumë se një shekull.

Ekipet e kërkim-shpëtimit dhe qentë e angazhuar në këto përpjekje kanë mbuluar vetëm 3 për qind të zonës së kërkimit, tha shefi i policisë në Maui, John Pelletier. "Kemi një zonë që duhet ta kontrollojmë prej të paktën 5 mijë katrorë e që është e mbushur me më të dashurit tanë", tha ai, duke shtuar se numri i viktimave ka të ngjarë të rritet pasi "asnjëri prej nesh nuk e di ende shkallën" e kësaj fatkeqësie.

Zjarret që nisën ditë më parë kanë rrafshuar qytetin e vjetër të Lahainës.

Pelletier tha se identifikimi i viktimave është jashtëzakonisht sfidues sepse "sapo ne marrim mbetjet mortore, ato shpërbëhen". Ai shtoi se dy persona deri më tani janë identifikuar. "Kjo është fatkeqësia më e rëndë natyrore që Havai ka përjetuar ndonjëherë", tha guvernatori Josh Green teksa pa nga afër shkatërrimet nga zjarri. "Ne



vetëm mund të presim dhe t'i mbështetim të mbijetuarit. Fokusi ynë tani është t'i bashkojmë njerëzit dhe t'u ofrojmë strehim, kujdes shëndetësor dhe më pas ta nisim rindërtimin".

Të paktën 2 200 ndërtesa janë dëmtuar apo shkatërruar në Mauiin Perëndimor, tha Green, dhe 86 për qind e tyre ishin ndërtesa banimi. Ai shtoi se në mbarë ishullin dëmet vlerësohet se janë afër 6 miliardë dollarë. Sipas guvernatorit, do të "duhet

një kohë e gjatë" për rimëkëmbje.

Të paktën dy zjarre të reja kanë shpërthyer në Maui, por ende nuk është raportuar për viktima. Për shkak të zjarreve, të paktën 4 500 banorë që janë evakuuar kanë nevojë për strehim, thanë zyrtarët.

Autoritetet u kanë bërë thirrje banorëve që të japin mostra të ADN-së në mënyrë që të mund t'i identifikojnë viktimat.

Numri i ri i viktimave ka tejkalluar numrin e viktimave nga zjarri në

veri të Kalifornisë më 2018, kur vdiqën 85 persona. Një shekull më parë, në veri të Minesotës, nga një zjarr kishin vdekur qindra persona.

Zjarret në Havai janë fatkeqësia më e madhe natyrore në dekada, duke tejkalluar edhe cunamin e vitit 1960, që la të vdekur 61 persona.

Sipas të dhënave të menaxhimit të emergjencave në Havai, nuk ka pasur sirena para se zjarret t'i kaplonin qytetet. Zyrtarët u kanë dërguar banorëve mesazhe në

telefona mobilë dhe kanë njoftuar përmes televizioneve dhe radiostacioneve. Por, në kohën e shpërthimit të zjarreve ka pasur ndërprerje të energjisë dhe të linjave të komunikimit.

Zjarret janë përkeqësuar edhe më shumë për shkak të thatësisë dhe erërave të fuqishme të shkaktuara nga një uragan që ka kaluar afër Maui.

Qyteti më i goditur është Lahaina, ku janë shkatërruar pothuajse të gjitha ndërtesat. Ky qytet është shtëpi e 13 000 banorëve.

## DW: Letra anonime kundër xhamive në Gjermani



BERLIN, 13 GUSHT - Pasiguri në komunitetin mysliman në Gjermani - një ndjenjë e përzier e shqetësimit, frikës dhe madje e zemërimit po rritet. Prej vitësh komunitetet myslimane në Gjermani marrin letra kërcënuese, pak të tjera u drejtohen kishave.

Në fillim të gushtit një letër anonime mbërriti në komunitetin mysliman në Osnabryk. Policia e qytetit, sipas zëdhënësit Matthias Bekermann,

thekson, se bëhet fjalë në radhë të parë për "shpifje kundër personave privatë nga zona e Osnabrykut". Deri tani policia është e mendimit, se përzgjedhja e të adresuarve është e pavarur nga "përkatësia fetare", tha Bekermann i pyetur nga Deutsche Welle.

Kjo mund të vlejë për disa raste në Osnabryk, por edhe në pjesë të tjera të Saksionisë së Poshtme, Hesën, Bavari e Berlin xhamitë kanë marrë në vitet e kaluara disa

letra kërcënuese. Numri i përgjithshëm i letrave anonime duhet të jetë më i lartë sesa duhet. Sipas informacioneve të Deutsche Welles, komunitetet myslimane e informojnë policinë, por nga ana tjetër heqin dorë nga vëmendja mediatike. Edhe përfaqësues të caktuar nga shoqatat myslimane marrin letra kërcënuese, madje aty përmenden pjesërisht edhe anëtarë të familjes dhe fëmijë minorene.

## Kievi raporton për të paktën 500 fëmijë të vrarë që nga nisja e pushtimit

KIEV, 13 GUSHT - Të paktën 500 fëmijë janë vrarë dhe mbi 1 000 janë plagosur që kur Rusia nisi pushtimin e plotë të Ukrainës shkurtin e kaluar, tha Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Ukrainës më 13 gusht.

Zyrtarët e Ukrainës thanë se këto shifra nuk janë të

kompletuara për shkak të vështirësisë së mbledhjes së të dhënave në zonat e pushtuara nga forcat ruse.

Muajin e kaluar Komisionari i Lartë për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara raportoi se të paktën 9 396 civilë ishin vrarë. Sipas këtij institucioni, edhe 16 646 të

tjerë janë plagosur.

Rusia po vazhdon të kryejë sulme ajrore në mbarë qytetet ukrainase, edhe pse vazhdimisht mohon se shënjestron infrastrukturën civile. Ndërkaq, Ukraina po vazhdon kundërofensivën e saj për t'i dëbuar nga territoret e pushtuara forcat ruse.



# Pendarovski kërkon sanksione për “provokimet nacionaliste” gjatë vizitës së Kurtit



Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka kërkuar sanksionimin e drejtuesve të komunës së Çairit dhe Tetovës për, siç ka thënë, “provokimet nacionaliste që propozojnë ide shoviniste të shteteve të mëdha” gjatë vizitës së kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, të premtën, më 11 gusht, në Tetovë dhe Çair të Shkupit. Kurti ishte pritur me ikonografi shqiptare, flamuj e simbole të tjera kombëtare shqiptare. “Vendosja e ikonografisë provokuese nacionaliste, që promovon ide shoviniste të shteteve të mëdha, paraqet nxitje të urrejtjes dhe jotolerancës etnike...”, u tha në reagimin e presidentit maqedonas

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 13 GUSHT** - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka kërkuar sanksionimin e drejtuesve të komunës së Çairit dhe Tetovës për, siç ka thënë, “provokimet nacionaliste që propozojnë ide shoviniste të shteteve të mëdha” gjatë vizitës së kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, të premtën, më 11 gusht, në Tetovë dhe Çair të Shkupit. Kryeministri Albin Kurti qëndroi në këto dy komuna të banuara me popullatë shqiptare, me ftesë të kryetarit të Çairit, Visar Ganiu, dhe atij të Tetovës, Bilall Kasami.

Kurti mori pjesë në përrurimin e një rrugë me emrin e veprimtarit Adem Demaçi në Çair, ndërsa në Tetovë mori pjesë në lëshimin në përdorim të një rruge në Malësinë e Tetovës. Gjatë kësaj vizite Kurti dhe kreu i Tetovës folën edhe mbi nevojën e hapjes së një tuneli me gjatësi prej rreth 6 kilometrash, që do t'i lidhte Tetovën me Prizrenin. Kurti ishte pritur me ikonografi shqiptare, flamuj e simbole të tjera kombëtare shqiptare. “Vendosja e ikonografisë provokuese nacionaliste, që promovon ide shoviniste të shteteve të mëdha, paraqet nxitje të urrejtjes dhe jotolerancës etnike, nga të cilat pa mëdyshe

goditen parimet dhe vlerat bazë të Marrëveshjes Kornizë si dhe koncepti i Maqedonisë si shtet multi-etnik”, u tha në reagimin e presidentit maqedonas Stevo Pendarovski.

Ai ka reaguar edhe për “mosrespektimin e Ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Maqedonisë së Veriut”. “Organizatorët e tubimeve publike në Tetovë dhe Çair duhet të sanksionohen ligjërisht për shkeljen e dispozitave ligjore për përdorimin e flamurit dhe himnit shtetëror dhe flamujve dhe simboleve të komuniteteve, duke i injoruar plotësisht simbolet e shtetit. Në këtë drejtim u bëj thirrje organeve kompetente që sa më parë t'i kryejnë procedurat e parapara”, thuhet në reagimin e Pendarovskit, i cili ngriti dilema edhe për shkeljen e procedurave për emërtimin e rrugës në Çair me emrin e Adem Demaçit.

“Mënyra e realizimit të idesë së riemërtimit të rrugës në komunën e Çairit bie ndesh me parimin e debatit demokratik dhe respektimin e trashëgimisë historike të të gjitha komuniteteve në shtet. Në këtë kuptim, pres që shërbimet kompetente inspektuese të kontrollojnë nëse është respektuar parimi i shumicës së dyfishtë me rastin e marrjes së vendimit, ku duhet të përfshihen edhe votat e komuniteteve që

nuk janë shumicë në atë komunë”, u tha në reagimin me shkrim të presidentit të Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, të dielën më 13 gusht.

Ndaj këtyre deklaratave ka reaguar Izet Mexhiti, ish-kryetar i Çairit, tani kryetar i partisë së re Lëvizja Demokratike, me përfaqësuesit e së cilës është takuar Kurti. “Mendoj se kjo vizitë duhet parë pozitivisht, pasi u promovuan projekte të përbashkëta, siç është rruga Tetovë - Prizren, e cila do t'i bashkojë njerëzit, do t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik dhe turizmit më të madh. Unë do t'ju kërkoj të mendoni më pozitivisht. E shoh që me çdo kusht dëshiron të gjesh diçka. Ishte një miting. Na ndodh çdo ditë, shoh edhe harta nga ‘Maqedonia e Madhe’. Ne ishim edhe në komunën e Tetovës, ku para ndërtesës së komunës ka flamuj edhe maqedonas, shqiptarë dhe komunalë. Nëse duam t'i shohim, duhet të bëjmë probleme me çdo kusht”, tha Mexhiti.

Ai theksoi se shembulli me emërtimin e rrugës me emrin “Adem Demaçi” nuk duhet të jetë problem pasi, sipas tij, bëhet fjalë për një person me vlera evropiane, fitues i çmimit Sakharov të ndarë nga Parlamenti Evropian dhe luftëtar për të drejtat dhe liritë njerëzore e

kombëtare të shqiptarëve të Kosovës.

Veç presidentit Stevo Pendarovski, për vizitën e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, kanë reaguar edhe partitë e tjera maqedonase, ndërsa partia “E majta” ka kërkuar që Kurti të shpallet “Persona non grata” (person i padëshiruar).

Kryetari i Tetovës, Bilall Kasami, duke iu përgjigjur deklaratës së presidentit dhe Qeverisë së Maqedonisë, ka theksuar se qeveria nuk ia doli ta fshehtë apo kontrollojë frikën nga humbja në zgjedhjet e ardhshme, sidomos kur në pah doli fronti opozitar i bashkuar dhe me një përkrahje nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. E kuptojmë shqetësimin e presidentit dhe qeverisë, së cilës, për çudi, me përkrahje e reagime i doli krah edhe Beogradi, dhe e dimë se retorika e këtyre politike nuk ka të bëjë aspak me vizitën e Albin Kurtit, por ka të bëjë me shqetësimin se opozita shqiptare në RMV po bashkohet dhe kësaj ia numëron ditët kësaj qeverie të kimit dhe korrupsionit. Ardhja e kryeministrit Kurti sa ishte respekt dhe nder për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, po aq ishte edhe respekt për shtetin e Maqedonisë së Veriut, me të cilin është nënshkruar memorandum i projektit të përbashkët, rrugës Tetovë - Prizren”, ka shkruar ai në “Facebook”.



# Rama: Të qenit i majtë s'më pengon të bëj zgjidhje që mund të interpretohen si të djathta

“Shqipëria është destinacioni i një numri gjithnjë në rritje turistësh, veçanërisht evropianë”, shkruhet në artikullin e medias italiane “Libero”, ndërsa zhvillimi turistik i Shqipërisë vijon të bëjë jehonë në mediet ndërkombëtare. “Libero” ka zhvilluar një intervistë me kryeministrin Edi Rama, ku prekën temat si turizmi, politika apo marrëdhënia me homologen Giorgjan Meloni. Kreu i qeverisë shqiptare theksoi se e ardhmja e Shqipërisë do të varet shumë nga e ardhmja e Evropës e cila po plaket gjithnjë e më shumë

**TIRANË, 13 GUSHT** - Një herë ishte Shqipëria e Enver Hoxhës. Ishte si Rusia e Brezhnevit dhe Kina e Maos. E varfër dhe e tiranizuar. Shqipëria ishte në Evropë një lloj enklave e blinduar, me fe komuniste dhe ritual kinez. Askush nuk hynte dhe askush nuk dilte. Pastaj, në fillimet e viteve '90, rrëzimi i regjimit, ikja masive e qindra mijëra njerëzve drejt Italisë dhe Evropës, anijet e përshkruara në filmin “Lamerica” nga Gianni Amelio dhe fillimi i normalizimit.

modern. Është destinacioni i një numri gjithnjë në rritje turistësh, veçanërisht evropianë. E drejton një kryeministër me prirje socialiste që quhet Edi Rama. 59 vjeç. 1 metër e 98 cm i gjatë. Ka luajtur basketboll, pikturon, shkruan, ka dhënë mësim.

*Ju keni thënë se e vlerësoni shumë Giorgjan Melonin. Megjithatë, ju jeni socialist. Cila është dallimi midis të djathtës italiane dhe së djathtës shqiptare?*  
**Rama:** Në skenën ndërkombëtare, Giorgja i ka

surprizuar të gjithë, e do të thosha alla grande, sepse teksa prisnin një përbindësh fashist që do të marshonte mbi Evropë, u gjendën përballë një gruaje me aftësi mahnitëse në komunikim si një evropiane e thekur, që deri më tash s'ka thënë asgjë gabim. E djathta, e majta, fashizmi, socializmi kanë kuptim kur flasim për histori, por kërkimi i sensit të tyre të hershëm në politikën e sotme mund të na ngatërrojë me këmbët tona. Po, unë jam socialist, i bindur për rrugën e Tretë të Klintonit, Blairit, Schroederit, Romano Prodit. Por, të qenit i majtë nuk më pengon të bëj zgjedhje që pastaj mund të interpretohen si të djathta, ashtu siç jo të gjitha ato që mbajnë vulën si zgjedhje të majta janë ilaçe që duhen gëlltitur duke kënduar “BellaCiao”! Dhe pastaj, në kohën e teknologjisë së re, Inteligjencës Artificiale, globalizimit, ka rrezik që të mbytemi në një gotë ujë duke përzier koncepte të vjetra me probleme dramatike për të zgjidhur. Ne duhet të rishpikim gjithë ç'është e mundur dhe të rishpikemi me ngulm në një botë që ndryshon pa marrë as frymë.

*Ju keni kritikuar zgjedhjet e kaluara të Italisë! A mendoni se të majtët italianë nuk janë mjaftueshëm modernë?*

**Rama:** E kush jam unë për të gjykuar nëse të majtët italianë janë mjaftueshëm modernë apo të dalë kohe? Çfarë është Massimo D'Alema, modern apo i dalë kohe? Kur e dëgjoj atë, më duket sikur kam para vetes dikë që e rrok shumë më mirë të ardhmen se sa unë dhe shumë të rinj që hedhin salcë mbi veprat e Rafaelos apo Van Gogut!

*A janë të përputhshëm moderniteti dhe socializmi?*

**Rama:** Kjo varet nga çfarë kuptojmë me socializëm. Nëse me “socializëm” kemi parasysh ëndrrat e lavdishme të së shkuarës që nuk u bënë kurrë realitet, atëherë jo, nuk janë të përputhshëm. Por nëse kemi parasysh ide dhe vlerat të caktuara, atëherë po, absolutisht! Dhe pastaj, duhet të kemi shumë kujdes për mënyrën se si ato ide dhe vlera na shërbejnë për të shkuar përpara, luftuar, reformuar, transformuar, duke e pranuar çdo dhimbje që sjell modernizimi sjell. Pa bërë

gabimin të kthehemi mbrapa në kërkim të gjetjes së mbështetjes së kollajtë në pakënaqësitë e gjendjes.

*Cili është gjykimi juaj për politikën që po zgjedh e djathta e re në Itali?*

**Rama:** Unë vlerësoj Giorgjan, dhe kaq. Dhe respektoj të gjithë udhëheqësit politikë në Itali, pa ia lejuar kurrë vetes të jap gjykime mbi punën e tyre në shtëpinë tuaj. Ka shumë njerëz që e bëjnë këtë, nuk ka nevojë edhe për një tjetër më shumë që flet pa pasur atributet për të analizuar seriozisht faktet.

*Çfarë mendimi keni pasur për Berlusconi?*

**Rama:** E kam njohur shumë pak, por e kujtoj i buzëqeshur. Dhe e kam ridëgjuar e lexuar disa herë fjalimin e kryepeshkopit në funeralin e tij, një adresim jashtëzakonisht i bukur për një njeri, që le ta themi duke përdorur një eufemizëm, nuk ishte subjekti më i lehtë për një prift. Nga ato pak takime që kam pasur me të, kam krijuar ndjesinë e një njeriu që kishte një ndjeshmëri genuine ndaj Tjetrit.

# Urdhri operativ "Goditja", për pesë ditë 72 të arrestuar dhe 34 armë të konfiskuara



Prishtinë, 13 gusht - Policia e Kosovës ka arrestuar 72 persona dhe ka konfiskuar 34 armë brenda pesë ditësh në kuadër të zbatimit të urdhrit

operativ "Goditja". Ky urdhër po zbatohet në tërë vendin dhe ka për qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Policia ka njoftuar se ka

shtuar aktivitetet në drejtim të goditjes së personave apo grupeve që me veprimet e tyre mund të bien ndesh me ligjin. Sipas njoftimit të

policisë, nga data 8 deri më 12 gusht janë realizuar 2 154 pika kontrolli për automjete, 730 prej tyre me radarë dhe alkool-test. Gjithashtu, janë

kontrolluar 12 038 vetura dhe 229 lokale, ndërsa nga 72 personat e arrestuar, prej tyre 24 janë me urdhër-arrest nga gjykatat.

*Sipas jush, Giorgia është trashëgimtare e Berlusconit?*

**Rama:** Giorgia është trashëgimtare e një tigri, jo e një rinoceronti.

*A është i mundur bashkëpunimi midis socialistëve dhe të djathtëve në Evropë?*

**Rama:** Jam shumë kurioz të di.

*Si e kujtoni Shqipërinë me anije të mbushura me refugjatë që iknin drejt Italisë?*

**Rama:** Si një vend që pas shekujsh të jetuar në gjunjë filloi të vraponte duke thyer kockat e tij, për ta rishpikur dhe aftësuar vetveten për të qëndruar drejt.

*Ju keni jetuar për një kohë të gjatë, si fëmijë dhe si i ri, në Shqipërinë komuniste. Çfarë kujtoni nga ato vite?*

**Rama:** Shumë gjëra, por ndoshta për ju është më interesante të dini se kujtoj muzikën e Carosello-s dhe "Novantesimo Minuto", zërat e Raffaella Carra-s dhe Sandro Ciotti-it, si dhe heshtjet mediate të Bearzot-it, këngët e Celentano-s apo si hynte zhurmuesi me miza në ekranin e TG1 kur dilte Papa! Nënvizoj se TG1 dhe "Novantesimo Minuto" ishin të vetmet gjëra që mund të shiheshin në Tiranë, ku RAI ishte e "zhurmuar" nga regjimi, ndërsa

për Carosello-n dhe Raffaella Carra-n duhej të prisje verën në Vlorë, ku kur nuk kishte asnjë re në qiell, ne nuk shkonim në plazh sepse RAI dhe Tele Norba mund të kapeshin direkt nëpërmjet korridorit të Otrantos, e regjimi nuk mund të bënte asgjë.

*A ju pëlqeu filmi "Lamerica"? A e njihnit Gianni Amelion? E vlerësoni atë?*

**Rama:** Ky film u prit keq në Shqipëri, sepse ishte hera e parë që kishim para syve pasqyrën e atij që ishte vendi ynë dhe vetë ne në atë periudhë dramatike! Nuk ishim të bukur dhe të lumtur, si në pasqyrën e propagandës së regjimit, por të shëmtuar dhe të egër, siç na kishte lënë regjimi. Të shikohesh në atë pasqyrë të pamëshirshme nuk ishte një përvojë e këndshme! Mua filmi më pëlqeu shumë dhe jam sherruar me miq që thoshin se filmi ishte poshtëruar. Nuk ishte Amelio që na kishte poshtëruar, po ata që na kishin mbajtur për dekada në bunkerin me drita të rreme të regjimit më brutal komunist në Evropë.

*Fashizmi dhe komunizmi kanë vdekur? Janë vetëm një kujtim i keq? Apo mund të kthehen?*

**Rama:** Nuk di nëse ka një shprehje italiane që në shqip



thotë, edhe engjëlli edhe djalli rrojnë brenda tek i gjalli! Fashizmi dhe komunizmi i shekullit të kaluar janë histori, por djalli që i ka pjellë ata është gjithmonë gjallë. Kush e di, ndoshta ai po përgatitet të hakmerret përmes mediave sociale dhe Inteligjencës Artificiale, duke përdorur përparësitë e mëdha të botës së lirë për të vrarë demokracinë...

*A është e vërtetë që ende keni*

*aktivitet artistik, në kohën që ju lejon politika?*

**Rama:** Po sigurisht, përndryshe do të isha tanimë në çmendinë.

*Energjia dhe turizmi: a janë të mjaftueshme për të siguruar të ardhmen e Shqipërisë?*

**Rama:** E ardhmja e Shqipërisë do të varet shumë nga e ardhmja e Evropës, e cila po plaket gjithnjë e më shumë. Nëse Evropa nuk arrin t'u bëjë derman goditjeve

marramendëse të një bote që po ndryshon me një shpejtësi të frikshme, ku fuqi të reja po sfidojnë rendin e vjetër botëror, atëherë Shqipëria e vogël nuk do të mund të arrinte atje ku unë jam i sigurt se do të arrijë! Jo vetëm me energjinë dhe turizmin, por edhe me teknologjinë, bujqësinë, kulturën dhe shumë të tjera.

*Çfarë mendoni për problematikën e emigracionit? Italia është vendi më i prekur. Si e vlerësoni politikën e ndërmarrë nga qeveria italiane në përpjekjen për të arritur marrëveshje me vendet e origjinës së flukseve migratore dhe për t'iu kundërvënë trafikantëve?*

**Rama:** Italia është viktimë e gjeografisë së saj në një Evropë të bashkuar që, fatkeqësisht, nuk është e bashkuar kur rruga bie në Lampedusa. Për t'i bërë moral dhe dhënë leksione Italisë ka shumë trajnerë brenda kufijve të Evropës, por kur vjen puna për të qenë një skuadër dhe për të luftuar plagën e kufirit tuaj detar, atëherë duket sikur ai nuk është më kufiri i Evropës, por thjesht kufiri i një vendi të vetëm. Italia ka nevojë për ndihmë dhe solidaritet, jo për moralizime dhe leksion mbi se si duhet të veprojë. Është e trishtë.

## Protestë në "mbrojtje" të Kurtit nga opozita dhe analistët

PRISHTINË, 13 GUSHT - Një protestë e çuditshme është mbajtur të dielën në sheshin "Skënderbeu" të Prishtinës. Dhjetëra persona kanë "protestuar"

në mbrojtje të qeverisë Kurti, sikur kanë thënë, nga opozita "jokonstruktive" dhe analistët televizivë. "Të sillen para gjyqit të gjithë"

analistët që janë kundër shtetit të Kosovës", ishte një nga thirrjet e protestës së thirrur nga një "qytetar nga Drenica" nëpërmes rrjeteve sociale.



## Gazetaret ukrainase: Njohja e Kosovës thjesht çështje kohe



PRISHTINË, 13 GUSHT - Në kuadër të programit "Gazetarët në Residencë", program ky i financuar nga qeveria, në Kosovë që prej shënimit të fillimit të luftës në Ukrainë kanë ardhur disa gazetarë. Për Ekonomia Online përjetimet e tyre i kanë rrëfyer Liudmyla Lukianchenko dhe Tetiana Kraselnykova.

Liudmyla Lukianchenko dhe Tetiana Kraselnykova u shprehën tejet falënderuese për pritjen që u është bërë në Kosovë, madje dhanë edhe mendimet e tyre se iu përket

raportimeve të fundit për njohjen e Kosovës nga ana e shtetit ukrainas.

Sipas Liudmyla Lukianchenko, njohja e Kosovës nga Ukraina është thjesht çështje kohe. Sipas saj, kjo nuk po ndodh tani ngaqë Ukraina është shumë e zënë duke u marrë me çka e preokupon atë momentalisht, e që është lufta dhe negociatat me aleatët e saj. "Unë vlerësoj se është thjesht çështje e kohës që Ukraina ta njohë Kosovën, sepse dhe Ukraina e ka gjetur veten në një pozitë të tillë", ka thënë Lukianchenko.

## Jasharaj: Greva nuk do të ketë në këtë fillim të vitit shkollor, ky është lajm i keq për Kurtin e Nagavcin

PRISHTINË, 13 GUSHT - Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka paralajmëruar se nuk do të ketë greva në këtë fillim të vitit të ri shkollor. Megjithatë, ai ka thënë se dialogu në mes të sindikatave dhe qeverisë duhet të vazhdojë për t'i evituar grevat dhe protestat e mundshme. "Greva nuk do të ketë në këtë fillim të vitit shkollor dhe ky është lajm i keq për Kurtin dhe për Nagavcin. Po të kërcënonim ne me greva ata do të kënaqeshin sepse do të harroheshin vaji, gruri, milionat për energjinë në veri, çerdhet e panisura, por edhe lojërat e këqija të Hekuranit për ndryshimet në Ligjin për Skemat Pesinonale".

I pari i SBASHK-ut thotë se presin që Nagavci dhe Murati t'i përfundojnë seancat gjyqësore e më pas të merren me problemet në arsim. "Punëtorët e arsimit po presin që zonja Nagavci t'i kryejë seancat gjyqësore bashkë me ministrin Murati pa presionin se do të ketë greva. Po presim që pas të gjitha proceseve gjyqësore, ministrja, që po i ikin



zëvendësministrat, t'u kthehet një ditë problemeve në arsim. Po presim që kryeministri pasi t'i kryej obligimet atdhetare në Greqi e Maqedoninë e Veriut të

kthehet në problemet e popullit të tij". Ai ka thënë se greva bëhen në një shtet me demokraci derisa, sipas Jasharajt, për momentin greva "s'kemi kujt t'i

bëjmë". "Po presim deri kur të kthehen deputetët nga pushimi e diaspora në Evropë, se veprimet sindikale bëhen ku ka shtet dhe demokraci, por edhe kur individ

kthehet në mit dhe cenon vazhdimisht lirinë e njerëzve. Të bëjmë greva kemi një mijë e një arsye, por s'kemi kujt t'i bëjmë", ka deklaruar i pari i SBASHK-ut.

## Përrjashtimi nga "Defender 2023", Berisha: Kosova humbi shansin ta certifikonte ushtrinë

PRISHTINË, 13 GUSHT - Ish-komandanti i UÇK-së, Hisen Berisha, ka deklaruar se Kosova me përjashtimin nga Defender 2023 humbi mundësinë e saj për ta certifikuar ushtrinë. Sipas Berishës, kjo mund të jetë edhe një nga arsyet se përse ministri i mbrojtjes, Armend

Mehaj, vendosi të japë dorëheqje. "Ne ishim shteti i vetëm apo forca e vetme që u penalizua në Defender 2023 dhe ishim shteti i katërt në botë nga 25 shtete që merrnin pjesë dhe që kishim numrin më të madh të ushtarëve. Fakti që ne u përjashtuam dhe u penalizuam nga ky

formacion ka bërë që Mehaj të shqetësohej. Ai e di mirë se çfarë do të thotë përjashtim. Domethënë humb shansin e validimit të certifikimit të kapaciteteve tona ushtarake për të qenë pjesë interoperative e operacioneve ndërkombëtare", ka pohuar Berisha në Euronews.



## Kurti: Luledielli, kulturë me rëndësi strategjike

PRISHTINË, 13 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se luledielli është kulturë me rëndësi strategjike. Kurti ka shkruar në "Facebook" se fermeri Shukri Sallahu ka mbjellë 30 hektarë me luledielli. "Luledielli është kulturë me rëndësi strategjike andaj edhe fermeri

shembullor Shukri Sallahu ka mbjellë 30 hektarë me të. Ai produktin final e ka tanimë të dedikuar për eksport për shkak të kërkesës së lartë në treg për lëndën e parë. Përmes Programit për Pagesa Direkte 2023, një hektar me luledielli është përkrahur 454 euro, përfshirë këtu

subvencionimin e naftës dhe plehërimit. Shukriu këtë vit ka fshirë 100 hektarë me grurë si dhe pret të korrë edhe 15 hektarë me misër. Sipërfaqet e mbjella me luledielli ishin 48 hektarë në vitin 2022, ndërsa këtë vit janë pothuajse 300 hektarë, pra rreth 521 % më shumë", ka shkruar Kurti.



## Policia e Kosovës në dy raste të ndara parandalon kontrabandë të mallrave nga Serbia

PRISHTINË, 13 GUSHT - Zyrtarë policorë nga Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare (DRPK) Lindje gjatë realizimit të detyrave të tyre në brezin kufitar me Serbinë, në dy raste të ndara ndaluan dy vetura që bartnin mall të kontrabanduar. "Rasti i parë: më 12.08.2023 rreth orës 04:46 njësitet e Task Forcës së DRPK-së Lindje, gjatë një pike vëzhgimi në fshatin Muqibabë, ka pikasur që nga territori i Serbisë për në territorin e Republikës së Kosovës po vinte një veturë, me të cilën dyshohej se po kryhej kontrabandë me mall", ka njoftuar policia. Policia ka arritur ta ndalojë veturën me targa serbe që drejtohej nga M. S., mashkull serb, në rrugën Muqibabë - Pasjan. Gjatë kontrollit në veturë janë gjetur mallrat: 24 litra verë, 600 shishe birra dhe 260 shishe uji mineral

dhe natyral. Rasti i dytë: Më 12.08.2023, rreth orës 04:46, njësitet e Task Forcës të DRPK-së Lindje, gjatë një pike vëzhgimi në fshatin Muqibabë, kanë vërejtur që nga territori i Serbisë për në territorin e Republikës së Kosovës po vinte një veturë, me të cilën dyshohej se po kryhej kontrabandë me mall", ka njoftuar policia. Policia ka arritur ta ndalojë veturën me targa serbe që drejtohej nga M. S., mashkull serb, në rrugën Muqibabë - Pasjan. Gjatë kontrollit në veturë janë gjetur mallrat: dy paketa mish dhe 640 shishe birra. Lidhur me të dyja rastet është kontaktuar prokurori kujdestar, i cili ka rekomanduar që të dyshuarit të lirohen, ndërsa malli i lartshënuar së bashku me automjetet të dorëzohen në Terminalin Doganor.



## Masat e BE-së, Rafuna: Pasoja në ekonomi, po dëmtohet imazhi në sytë e investitorëve të huaj

Prishtinë, 13 gusht - Janë bërë më shumë se një muaj kur Bashkimi Evropian vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës si rrjedhojë e situatës në veri. Këto masa po ndikojnë edhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulëzim Rafuna, thotë se kjo situatë po ndikon tek investitorët e huaj të cilët janë të interesuar të investojnë në Kosovë.

Edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) kanë deklaruar ditë më parë se nëse masat e BE-së mbesin gjatë në



fuqi do të jenë pengesë për zhvillimin ekonomik të vendit. Kryetari Rafuna, në një

intervistë për "KosovaPress", duke treguar për sektorët që po pësojnë më së shumti nga këto

masa, ka folur edhe për trendet ekonomike në vend dhe për kërkesën e bizneseve që t'i rrisin sërish çmimet pas shtrenjtimit të derivateve. "Pasoja janë në dy aspekte negative. E para është çështja e imazhit për investitorët potencialë të cilët vijnë për të investuar në vendin tonë. Vendosija e masave ndëshkuese nuk ka qenë mesazh i mirë dhe nuk është mesazh i mirë. Jemi duke parë edhe tani që shumë investitorë të mëdhenj të cilët vijnë dhe paraqiten kanë sugjerime prej vendeve të tyre, prej qeverive,

prej organeve kompetente të tyre, që të kenë kujdes me investimet në Kosovë. Dhe një ndër arsyt janë pikërisht masat ndëshkuese që i vendosen Kosovës. E dyta, pasojë tjetër negative për shkak që ato fonde që ishte dashur të vijnë dhe të përfitojë Kosova sikurse çdo shtet tjetër i Ballkanit, siç është fondi prej 7 miliardësh për digjitalizimin, ne jemi përjashtuar dhe nuk kemi mundur të përfitojmë. Kështu që ato pasoja më së shumti i ndiejnë biznesi dhe qytetarët e Kosovës", ka theksuar Rafuna.

## Murati: Të moshuarit mbi 80 vjeç që s'mund të lajmërohen në zyrat e pensioneve po vizitohen nga ekipet mobile

PRISHTINË, 13 GUSHT - Pensionistët mbi 80 vjeç që s'mund të paraqiten në zyrat e shtetit për të dëshmuar se janë gjallë, në mënyrë që të vazhdojnë ta marrin pensionin, po vizitohen nga ekipet mobile, ka njoftuar ministri i Financave, Hekuran

Murati. Ai ka shkruar në "Facebook" se ky program prej korrikut është shtrirë në të gjithë vendin. "Po vazhdojnë vizitat në shtëpi për pensionistët që janë mbi 80 vjeç apo që për shkaqe shëndetësore nuk mund të paraqiten fizikisht në zyrat e pensioneve. Pas pilotimit

me sukses të këtij programi, që nga muaji korrik e kemi shtrirë në të gjitha komunat dhe tani ekipet mobile i vizitojnë të gjithë ata që për shkak të moshës së shtyrë apo shëndetit e kanë të vështirë paraqitjen fizike në zyrat përkatëse", ka shkruar Murati.




# Shembuj drejtësie nga Manastiri i vitit 1621-1623, sipas defterit osman të kadiut

Nga: Agron ISLAMI

Slogani i administratës osmane ishte Drejtësia, për të cilën përgjegjës dhe mbikëqyrës kryesor ishte vet Sulltani i cili përfaqësonte autoritetin e të drejtut. Ndarja e drejtësisë bëhej nëpërmjet institucionit të gjykatës së sheriatit, të cilat përfaqësoheshin nga eminentët që në literaturë njihen si kadilerë. Kadiu i cili përzgjidhej për ta ndarë drejtësinë në kaza/zytet, dekretonte me "Berat" (dekret) nga ana e sulltanit osman. Kadiu kishte kompetenca në drejtimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me anën ligjore në kaza, që nënkupton se mbikëqyrte dhe merre vendime për të gjitha mosmarrëveshjet në mes qytetarëve, sikur vjen fjala: mbikëqyrte kontratat e shitblerjes; me kërkesën e qytetarëve bënte kurorëzime dhe shkurozime; ruante pasurinë e fëmijëve që mbeteshin pa prindër në moshë të re dhe, kur ata arrinin moshën e pjekurisë (Bulûg), ua ndante pasurinë në pjesë të barabarta; përkujdesej për çmimet e artikujve në tregje si dhe kumtonte të gjitha urdhrat/dekretet dhe kërkesat që vinin nga qendra e Perandorisë drejtuar popullatës së qytetit, ku ai ishte nëpunës, që nënkupton se kishte autoritetin e kryetarit të komunës së sotme.

Te gjitha lëndët e përpunuara nga kadiu osman ruheshin në defterë të veçanta të cilat njihen si Şer'iyye Sixhilleri, e që edhe në literaturën e historisë shqiptare njihen si sixhile apo sixhilate. Ndërsa, gjuha në të cilën janë të shkruara sixhilet është osmanishtja me llojin e shkrimit Talik i thyer, Divani dhe Siyakat, shkrime të cilat gjatë leximit sjellin shumë telashe. Sixhilet e kadiut përveç informacionit të rëndësishëm mbi drejtësinë e kohës, në vete përmbajnë edhe informacion të dorës së parë për sa i përket administratës osmane të kohës, jetës sociale, ekonomike dhe kulturore dhe si të tilla janë burimi i parë për historinë e qytetit të kohës osmane. Këto dokumente të hartuara nga ana e kadiut, karakterizohen me të dhëna të detajuara për lagjet, me shkëmbimin e shkresave /urdhëresave mes qytetit dhe qendrës së Perandorisë, kërkesat dhe ankesat e ndryshme të banorëve vendas. Me një fjalë, përmes këtyre shkresave mund ta krijojmë një pikëpamje të saktë mbi jetën e paraardhësve tanë gjatë kësaj kohe. Në anën tjetër, në këto regjistra të kadilerëve gjejmë edhe të dhëna të detajuara të sistemit komunal, tatimorë (vergi), prodhimtarisë bujqësore, sëmundjet e kohës dhe jetën e familjes shqiptare në



përgjithësi. Pa përfshirë edhe dekretet e lëshuara nga qendra e Perandorisë Osmane drejtuar qytetarëve të zonës në fjalë, sikur janë fermanet, beratet etj. Ajo që ia shtonte edhe me shume vlerën hulumtimit të sixhileve të kadiut, pa dyshim që janë edhe emrat e njerëzve, qyteteve, fshatrave, lagjeve, fiseve dhe xhematëve që kanë një vlerë të veçantë për historinë e gjuhës shqipe, dhe njëkohësisht japin mundësi të nxirren përfundime me shumë interes mbi anën etnike – veçanërisht mbi gjendjen e elementit shqiptar në këto qytete gjatë periudhës së sundimit osman.

## Gjykata e Manastirit dhe sixhiletat


Me 1385, atëherë kur edhe themelohet Bejlerbejliku apo Ejaleti i Rumelisë – i cili më vonë do të njihet me emrin Vilajet – hapësira e Maqedonisë Veriore të sotme bëhet pjesë e kësaj administrate të zgjeruar dhe, sipas kësaj, Manastiri ishte pjesë administrative e Pasha Sangjakut deri në shekullin XIX. Sipas të dhënave që na ofron seyahatnameja e Evlija Çelebiut, në gjysmën e dytë të shekullit XVII, Gjykata e Manastirit kishte në administrim sanxhakun e Kërçovës, Elbasanit, Gostivarit, Dibres, Resnës, Florinës, Prilepit, Ohrit dhe 360 fshatra. Numri i sixhileve të identifikuar të qytetit të Manastirit është 185, të cilat përfshinë një interval kohor të regjistrimeve prej 306 vjetësh, respektivisht sixhili i parë mbanë datën 1621 dhe i fundit 1927. Për sa i përket larmisë së tematikave të lëndëve, apo vendimeve që janë marr nga ana e kadiut të qytetit të Manastirit në vitet 1621-1623, shohim se ato janë të natyrave ekonomike, fondacioneve/vakëfet, problemeve familjare, Ushtisë, rrahjeve, plagosjeve, veprave penale krimeve ... pa u anashkaluar edhe lëndët e

shumta të trashëgimisë. Siç edhe dihet, hapësira shqiptare e periudhës osmane karakterizohet me multikulturalizëm. Respektivisht, duke qenë se në këto zona nënshtetasit osmanë i takonin besimeve të ndryshme, edhe bashkëpunimi i tyre në jetën e përditshme ishte i patejkalueshëm. Kjo vjen edhe si rezultat i qytetërimit osman i cili është ngritur mbi themele të juridiksionit islam, ku e drejta e jetës dhe e besimit është e garantuar me ligj. Ky bashkëpunim dhe bashkëjetesë shpërfaqet mjaftë mirë edhe në dekadën e dytë të shekullit XVII. Siç është rasti me Salamonin, i

cili ishte nga hebrenjtë (jahudinjtë) dhe i kishte dhënë një hua prej tri akçeve (groshësh) Muhamedit, një qytetari të besimit islam. Në këto regjistrime zyrtare nuk mungon as elementi gjinor, ku zonjat shfrytëzonin të drejtën e trashëgimisë dhe të drejtën e menaxhimit me pasurit e tyre dhe të familjeve të tyre. Sikur vjen fjala me një zonjë nga lagja e quajtur Nexhip në Manastir. Kjo zonjë, me emrin Ajshe, kishte shkuar ke Kadiu i qytetit për të konfirmuar/noterizuar shitjen e pjesës (hises) së saj, të cilën e kishte trashëgim nga familja, bashkë me vëllain e saj. Duke qenë se përgjegjësia e

kadiut ishte ndarja e drejtësisë, dera e tij duhej të ishte e hapur për çdo qytetar të kazasë ku ai shërbente. Përgjegjësia dhe kompetencat e tij kapnin edhe problemet e dhunës në familje. Një lënë e karakterit të dhunës në familje është regjistruar me rastin e ankesës së një zonje të besimit të krishterë, me emrin Elina. Në këtë lëndë, me shumë pak detaje thuhet se i është tërhequr vërejtja Stojkos, që mos të ushtrojë dhunë (presion) ndaj rejes së tij, Elina. Një rast dhune është regjistruar edhe në lëndën me nr. 250. Sipas kësaj, Haxhi Ahmedi ushtron ankesë ndaj gjyshit të tij, Hasanit, me pretekstin se është rrahur nga ky i fundit. Për të verifikuar pretendimin në fjalë, gjykata kishte dërguar një zyrtar dhe pas kësaj Hasani i ishte nënshtruar kërkesave të zyrtarit. Fakti që për këto dy raste të dhunës në familje gjykata nuk kishte shqiptuar ndonjë dënim, mund të vijmë në përfundim se zyrtarët e drejtësisë i kishin dhënë përparësi zgjidhjes së problemeve nëpërmjet marrëveshjeve në mes familjarëve konfliktuoz. /Telegrafi/

– Shkëputje nga punimi shkencor "Sixhiletat e kadiut osman si burim i dorës së parë për historishkrimin e qyteteve shqiptare (shembulli i Manastirit)", i botuar në revistën Dituria Islame nr. 382 (2022), f. 47-50–



Faksimil nga sixhili i Manastirit

# Xhubleta dhe marrëzia jonë atdhetare



Nga: Monika STAFA

Shumë është folur e shkruar, ndonjëherë edhe me një ngazëllim të habitshëm, se shqiptarët kanë qenë dhe janë populli më i varfër i Evropës. I varfër në toka. Por, jo aq në male. Në det, lumenj apo dhe liqene. Ndoshta ky paradoks mes malit dhe tokës për syrin e një të huaji ka qenë një raport që nuk i ka mbushur mendjen fotografit të huaj për të përlloritur ushqimin bazë fillimisht të një shqiptari. Pasuri dhe mirëqenie nuk mendohej asesi. Lumturia dhe shëndeti që vijnë pas tyre padyshim jo e jo.

Por, ka diçka që mprehtas të kthen vështrimin për ta rimenduar dhe njëherë bollëkun e banorëve të këtyre anëve.

## Cila është ajo?

Cilat dëshmojnë kokëfortë se sa shumë është tepruar me përcaktime të tilla. Ato, në mos përditë, të paktën në çastet më solemne të jetës, i kanë dhënë mundësi njeriut shqiptar të shijojë luksin. Dhe, jo vetëm luksin e artizanatit vendas.

Një botim që i kushtohet pranisë së qytetërimit frëng në Shqipëri (La France dans les Archives d'Albanie, Tiranë 2005), duket qartë se zonjat shqiptare, pavarësisht nga gjendja e përgjithshme e zhvillimit të vendit, në vitet 1930 ndiqnin modën e Parisit dhe blinin bizhutë më të reja franceze që u shiteshin po atëherë zonjave frënge në sheshin "Vendôme".

\*\*\*

Regjistrimi i xhubletës në listën e trashëgimisë kulturore botërore të shpallura në mbrojtje të UNESCO-s si një veshje origjinale me lashtësi të kryehershme për njerëzimin përbën një ngjarje kulturore

me rëndësi për gjithë shqiptarët.

E, bashkë me të, drejt thesarit të trashëgimisë botërore kanë udhëtuar edhe disa pasuri të tjera shqiptare të pandashme prej saj. Areali i kryezonës së ruajtjes së xhubletës; areali i ruajtjes së lahutës, eposi heroik, kanuni, kulla, logu, bjeshkët, malësori si dhe jeta tradicionale.

Por, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se ka gjithmonë një dallim midis zonës së rrudhur, ku këto pasuri janë ruajtur deri në kohët moderne si trashëgimi e si mjeshtëri. Krahasuar kjo me zonën e përhapjes së kryehershme. Ndaj është e pashmangshme pyetja, a është xhubleta vërtet një veshje katër mijë vjeçe? Ku fillojnë dhe ku mbarojnë ilirët? Ku fillon dhe ku mbaron historia e xhubletës? Si ndahen këto epoka mes mitizimit nacionalist dhe asaj çka shkenca provon në të vërtetë?

## Kur do ta kuptojmë këtë marrëzi të shkencës atdhetare?

Në hapësirën historike-zanafillëse arbërore ndarja në dy makrozona, etnografikisht në toskë e gegë; gjuhësisht në toskërisht e gegnisht; në traditën muzikore në zonën e polifonisë e të homofonisë, ndodhi, sipas shprehjes së Eqrem Çabejt, në shekujt e kapërcyellit, bashkë me kalimin nga ilirët tek shqiptarët (shek. V-VII). Edhe në pikëpamje të tipologjisë së veshjes hapësira historike shqiptare është ndarë në të njëjtën kohë, në dy makrozona: të fustanellës në jug dhe të xhubletës në veri. Hartëzimi tipologjik i veshjeve shqiptare sipas kësaj vendosjeje lehtësohet prej analogjisë bindëse me ndarjen krahinore të popullit shqiptar prej Rrok Zojzit dhe ndarjen krahinore të Kosovës prej Mark Krasniqit, që janë vazhdim i njëra-tjetrës.

Mbështetur në të dhëna e argumente historike e kulturore, mund të besohet se dikur fustanella dhe xhubleta takoheshin mbi e nën Shkumbin, pa e penguar njëra-tjetrën, për t'u ngjitur

më lart apo për të zbritur më poshtë. Deri në mesin e shekullit të kaluar, me fustanellë visheshin e fotografoheshin kryezinjtë e Gjakovës, Hamzë Kazazi i Shkodrës dhe Ahmet Zogu i Matit. Në të njëjtën mënyrë xhubleta, në një formë të stilizuar, zbriste gjer në Berat, madje gjer në Lunxhëri.

Nga pikëpamja etimologjike, emri i xhubletës është lidhur me fjalën rrënjë të turqishtes çüppe, me kuptimin fustan, që është huajtur në shqip në disa forma: xhybe, xhubë, xhubletë, me sa duket dhe xhup.

Makrozona e xhubletës nisi të ngushtohet dhe të mbyllet kryesisht në atë areal që françeskanët e quanin Lekni, domethënë prej lumit Mat deri në rrjedhën e Drinit të Bardhë, atëherë kur shqiptarët u gjendën në përbërje të një supershteti krejt të ndryshëm prej qytetërimit të tipologjisë perëndimore, siç ishte ish-Perandoria Osmane. Kjo është koha kur ngushtohet edhe kryevatra e eposit dhe lahutës, areali i kanunit dhe deri-diku edhe i krishterimit.

Xhubleta dhe fustanella kanë plotësuar njëra-tjetrën dhe të dyja së bashku vetë identitetin shqiptar duke bashkëjetuar së paku prej kohës kur shqiptarët dolën prej burimit ilir. Në përshkrimet dhe imazhet që janë ruajtur për veshjet ilire, duke përfshirë veshjen e Teutës mbretëreshë (në mozaikë, p. sh.), nuk ka xhubletë.

Jo vetëm xhubleta e fustanella, por edhe veshjet e tjera tradicionale shqiptare, si veshja e Hasit, e Gurit të Bardhë, e Mallakastrës apo e Kurveleshit, kanë qenë dhe janë lajmëtare identifikuese për bartësin e vet.

Xhubleta ka identifikuar edhe statusin social të familjes. Sipas disa të dhënave që ruhen në arkivat e trashëgimisë, në arkën e nuses, në ditën e martesës, duhej të kishte, sipas gjendjes shoqërore dhe të pasurisë, tri, shtatë apo nëntë xhubleta secila për një ditë të shënjuar. Numrat nuk janë aspak rastësorë. Ata janë të gjithë numra simpatikë. Kryesisht në krishterim, por edhe në

parakrishterim.

Ngjyrat e xhubletës, stilizimet e saj, dallonin vajzën e fejuar, nusen në ditën e parë të martesës, gruan që sapo është bërë nënë, magjatoren apo baçicën e familjes patriarkale; zonjën që është nisur të dielën për meshë apo për të pagëzuar fëmijën.

Në këtë kuptim, xhubleta u jepte siguri atyre që e bartnin dhe u diktonte marrëdhënie respekti të tjerëve. Qofshin dhe kalimtarë të panjohur.

Vërtet mendojmë ende se kemi qenë kaq të varfër?

\*\*\*

Me xhubletën është i lidhur një prej ritualeve më të njohur tradicionale të viseve veriore shqiptare, festa e logut, e cila është cilësuar herë konkurs bukurie për vajzat, herë si dyluftim artistik i shpatës dhe xhubletës.

Siç kanë vlerësuar studiuesit, xhubleta duhej të ishte jo vetëm e bukur, por edhe funksionale, të mos e pengonte bartësen e vet në punë, në ndejë, në kcim apo në udhëtim. Prandaj meritojnë nderim jo vetëm mjeshtret që e ruajtën zejen e xhubletës, por edhe gratë e vajzat e hijshme që e kanë bartur.

Është interesante të vërehet se edhe leksiku që lidhet me punimin e xhubletës është shumë i hershëm dhe ka disa përkime aspak rastësore me arbërishten e sotme. Këto janë shenja të hershmërisë relative të xhubletës, që na çojnë në periudhën parashqiptare dhe na japin mundësi të veçojmë periudhën paraosmane.

Ndaj e theksojmë sa i takon hershmërisë absolute, në çdo rast duhet të mbahet në konsideratë koha kur u shfaqën ilirët si popullsi banuese e qëndrueshme në hapësirën subdanubiane e në anën tjetër të Adriatikut, si kufi pagabueshmërie.

\*\*\*

Veshja tradicionale shqiptare i ngjan një palimpsesti, ku epokat historike kanë fshehur gjurmën e tyre të pashlyeshme njëra pas tjetrës. Kjo është arsyeja që, aty ku syri i zakonshëm i njeriut sheh një

larmi të pafundme veshjesh, abstraksioni i specialistit zbulon afri deri në përputhje të tipeve të tyre. Në këto veshje, ashtu si në rastin e xhubletës, gjenden shenja të kulteve pagane, si dielli dhe yjet; shenja të totemeve të të parëve, si gjarpri; shenja të krishtërimit të hershëm, si peshku; shenja të krishtërimit të fshehtë ose të rifshehur prej fillimit të periudhës osmane e këndeje, si kryqi i stilizuar dhe simbole të tjera, që ngajjnë shpesh si monograme të kodifikuara me një mjeshtëri të rrallë.

Në veshjet tradicionale shqiptare, sidomos në ato veshje që arkeo-etnologjia provon një vijimësi prej antikitetit apo kohëve të mëvonshme çdo vijë, çdo dekoracion, çdo simbol, çdo ngjyresë që syrit të zakonshëm njerëzor mund t'i ngajë si një e njohur e rëndomtë, syrit të studiuesit i informon procese shumëshekullore evolucioni. Në këtë proces veshjet shqiptare kanë ruajtur etnicitetin e tyre, duke lejuar, megjithatë, që njeriu të shprehë individualitetin e tij në shije dhe në ngjyra.

Nuk është e rastit që studiueset albanologe L. Conti e O. Marquet shënjojnë një spirito reale, një frymë aristokratike dhe vetëdije mbretërore në veshjet e shqiptarëve mërgimtarë në Itali në periudhën e fundit të mesjetës (Spirito reale nei costumi della donna arbëreshe, Puglia 1988). Ky konstatim merr vlerë duke e vendosur në kontekstin e kohërave moderne.

Me plotësimin hap pas hapi të gjithë hapësirës shqiptare me enciklopedinë e kostumeve ndoshta do të lindë vërtet nevoja edhe për një fjalor gjuhësor-etnografik të përshkrimit të veshjeve. Jo vetëm çdo veshje e çdo kind, por gjithashtu çdo pjesë e tyre, çdo cep e qepje, çdo anë palë, kanë emrat e tyre të përveçëm, thujse krejt të pavlerësuar gjuhësisht e etnografikisht. Mendoni sa bukur do të jetë! Dhe katër mijë vjetët të shndërrohen në përrallë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Italia mbetet pa trajner, Mançini jep dorëheqje

ROMË, 13 GUSHT - Në këto ditë të nxehta gushti, futboli italian prodhon një lajm të papritur. Në mënyrë befasuese, Roberto Mançini largohet nga stoli i përfaqësues "azurre". Me anë të një deklarate për mediat,

FIGC bëri me dije se Mançini paraqiti mbrëmjen së shtunës dorëheqjen e tij me efekt të menjëhershëm, vendim që u pranua nga drejtuesit e Federatës. Ky lajm kapi të përgatitur të gjithë ambientin italian, pasi ky

vendim vjen pak përpara dy sfidave kualifikuese në "Euro 2024", kundër Maqedonisë së Veriut dhe Ukrainës. Mbyllet në këtë mënyrë një cikël me ulje ngritje, nga viti 2018 kur mori drejtimin e Italisë deri në 2023, 5 vite në krye të

përfaqësueses italiane, një aventurë që arriti kulmin në 2020 duke u shpallur kampion Evrope brenda në "Wembley". Pika më e ulët e kësaj rrugëtimi ishte mos prezenca në Botërorin e Katar.



## Balkani e Drita e nisin sezonin e ri me fitore

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

Prishtinë, 13 gusht - Kampionia në fuqi e Superligës, Ballkani dhe nënkampionia Drita, e kanë nisur edicionin e ri të Superligës në futboll me fitore, duke dëshmuar përvojën dhe kualitetin e tyre në sfidat e para të sezonit. Skuadra suahrekase e drejtuar nga trajneri Ilir Daja e mposhti Lirinë me një gol të shënuar nga Nazmi Gripshi në minutën e 65-të, me gjuajtje të saktë nga brendësia e zonës. Ndërsa gjilanasit e Dritës e nisën

sezonin e ri me fitore në derbin ndaj Llapit me rezultat 2-0. Pjesa e parë nuk pati gola, kurse rezultatit e zhblokoi Blerim Krasniqi pas një ore lojë kur e shfrytëzoi një harkim të Besnik Krasniqit. Ndërsa, Albin Prapashtica, që hyri si zëvendësues e konfirmoi fitoren e gjilanasve, me gol të minutës së 75-të, pas një kundërsulmi të shpejtë. Këto skuadra me këtë start të mirë dëshmuar se edhe në sezonin e ri synojnë të luftojnë për tituj. Prishtina ka shënuar fitore në duel me Feronikelin 74, me rezultat 3-1, në ndeshjen e

zhvilluar në Kampin Nacional në Hajvali. Prishtina e shfrytëzoi epërsinë numerike në fushë, pasi në minutën e 28-të Behar Maliqi u ndëshkua me karton të kuq. Vetëm gjashtë minuta më pas bardhekaltrit e gjetën rrugën e golit, kur Egzon Sinani realizoi me gjuajtje me kokë. Epërsinë në 2:0 e shtoi Hasan Hyseni, në minutën e 61-të, derisa shifrat në 3-0 i çoi Jalen Bielsa, në minutën e 69-të, me golin e shënuar me kokë nga afërsia. Ndërkaq mysafirët golin e nderit e shënuan në minutën e 86-të përmes Fiton Hajdarit.



Ndërkohë, Malisheva ka shënuar fitore si mysafire në Klinë në ballafaqim me Dukagjinin, me

rezultat 1-0. Golin e vetëm të kësaj ndeshje e shënoi Arlind Veliu, me të filluar pjesa e dytë.

## FHK-ja: Evropiani në Turqi, dëshmi për rritjen e ekipeve përfaqësuese




PRISHTINË, 13 GUSHT - Dy fitore, një barazim e tri humbje është bilanci i Përfaqësues U17 (vajzat) në Kampionatin Evropian (B) që përfundoi në Turqi. Kosova të dielën në ndeshjen për vendin e shtatë fitoi ndaj Letonisë me rezultat 39:27. Në ndeshjen e fundit në grup vajzat tona barazuan 29:29 ndaj Finlandës. Në ndeshjen e parafundit në grup fituan 34:29 ndaj Bullgarisë. Kanë humbur nga Sllovakia e Polonia me rezultat të lartë dhe nga Italia me rezultat 29:24,

ndonëse ishin në lojë deri në minutën e 50-të. Për herë të parë një ekip kombëtar për vajza të reja mblodhi pesë pikë në një Evropian. Sa për krahasim, dy vjet më parë në Lituani, Kombëtarja U17 kishte humbur 24:23 nga Letonia dhe 44:10 nga Finlanda. Pra ngritja është e evidente. Natyrisht, ka ende shumë hapësirë për përmirësim, por zhvillimi i ekipeve përfaqësuese është i duhuri. Kritikta e drejta e konstruktive natyrisht se i shërbejnë zhvillimit

të mëtejme të ekipeve kombëtare, por jo edhe ato që bëhen me prapavijë dhe me qëllime të caktuara, më së paku sportive. Puna e përkushtimi i FHK-së për zhvillimin e ekipeve kombëtare do të vazhdojë. Dëshminë për rritjen e mëtejme e presim menjëherë në vjeshtë, kur në vendin tonë mbahet IHF Trophy për vajzat e reja. Përmes IHF Trophy synojmë kualifikimin në Botëror me Kombëtaren U17 apo U19.

## UEFA vazhdon t'u besojë gjyqtarëve nga Kosova



PRISHTINË, 13 GUSHT - Gjyqtarët kosovarë vazhdojnë të bëjnë paraqitje të shkëlqyeshme në arenën ndërkombëtare, duke bërë që UEFA të vazhdojë të besojë tek ta për këtë edicion të ri të garave evropiane. Për ndeshjen e rëndësishme ndërmjet

skuadrës daneze, Nordsjælland dhe asaj rumune, FCSB, e cila do të zhvillohet të enjten në stadiumin "Right to Dream Park" në Farum, autoritetet e futbollit evropian kanë vendosur gjyqtarë kosovarë. Genc Nuza do të jetë gjyqtari kryesor i kësaj përballje,

me asistentë Fatlum Berishën dhe Arbnor Bullatovcin. Gjyqtari i katërt do të jetë Dardan Çaka. Kjo ndeshje është pjesë e rrethit të tretë të Ligës së Konferencës. Dueli i parë ndërmjet këtyre dy skuadrave në Rumani përfundoi pa gola (0-0). Krahas rritjes së

nivelit të futbollit vendor, është rritur dukshëm edhe niveli profesional i gjyqtarëve tanë, gjë e cila po vlerësohet edhe nga UEFA, pasi gjatë këtij edicioni gjyqtarët tanë në vazhdimësi janë deleguar në garat e Ligës së Konferencës.

## S'ka fitues në derbin Chelsea - Liverpool

LONDËR, 13 GUSHT - Chelsea dhe Liverpools nuk kanë shkuar më shumë se një barazim 1-1 në super ndeshjen e javës së parë të Premier Ligë. Në "Stamford Bridge" ndeshja nisi më mirë për ekipin e Klopp që gjeti

avantazhin në minutën e 18-të. Pas një aksioni spektakolar, Salah shërben në zonë për Luis Diaz, i cili me një prekje të lehtë e devijon "sferën" në kuadrat. Chelsea zgjohet dhe më kalimin e minutave fiton më

shumë terren. Në minutën e 37-të, pas një rrëmuje në zonën e Liverpoolsit, është Axel Disasi që tregohet i vëmendshëm duke mposhtur portierin Alisson. Pjesa e parë u mbyll më këtë rezultat,

ndërkohë që në fillimin e së dytës Blutë e Londrës janë më dominues në lojë dhe në raste. Në minutat shtesë të ndeshjes, të dyja ekipet kishin nga një mundësi të artë shënimi me Nunez dhe Mudryk.





ROYAL CROWN;  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA  
Since 1905

Columbus, Georgia, USA  
Since 1905  
0.5L